

V E N D I M
Nr. 506, datë 21.9.2000

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I KRYQËZIMIT NË ZONËN E PLEPAVE, DURRËS,
PJESË E SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5, pika 1, dhe 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i kryqëzimit rrugor në zonën e plepave, Durrës, pjesë e segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës së shpërblimit që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 12 106 748 (dymbëdhjetë milionë e njëqindëgjashtë mijë e shtatëqindëzvetetë) lekësh.
 4. Fondi për shpërblimin e pronarëve të shpronësuar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2000 i Ministrisë së Transportit, në zërin “Shpronësime”.
 5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit tetor 2000.
 6. Punimet për realizimin e projektit të fillojnë pas mbarimit të procedurave të shpronësimit dhe të mbarojnë brenda muajit nëntor 2000.
 7. Ngarkohet Ministria e Transportit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

**Lista e pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të segmentit rrugor
Durrës-Rrogozhinë**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: Truall Nr. (1-3)

Nr.	EmërAtësi Mbiemër	V.K.K.K.P (datë)	Leje ndërtimi (datë)	Sip.trualli m2	Çmimi (lekë/ m2)	Vlera në (lekë)	Shënime
1.	Demir Xhafa	7.3.1994	23.9.1996	805 m2	26515	2134457	
	Demir Xhafa						Pretendim
2.	Rexhep Hersi	25.12.1995	23.9.1996	3230	26515	8564345	Pronësie
3.	Hamza Muça	4.7.1996	23.9.1996	531	26515	1407946	Në gjykim
	Shuma:			4566		12106748	